



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Aritech" Sh.P.K. të datës 13.10.2023 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje teknologjike (IT, shkencë) për kabinete në IEAA" me nr. të prokurimit 616-23-9220-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Aritech" Sh.P.K. e datës 13.10.2023 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje teknologjike (IT, shkencë) për kabinete në IEAA" me nr. të prokurimit 616-23-9220-1-1-1
- II. DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëjë korigjimin e kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. NJOFTOHET** operatori ekonomik "Aritech" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Aritech" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 13.10.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje teknologjike (IT, shkencë) për kabinete në IEAA" me nr. të prokurimit 616-23-9220-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: *“Lidhur me kërkesat per ISO Certifikata ISO 9001 dhe 27001 origjinal ose kopje e noterizuar nga origjinali. KRPP ka sqaruar lidhur me kërkesat per ISO si në vijim (26. 09.06.2023 - KRPP rekomandon zyrtarët e prokurimit që me rastin e vendosjes së kritereve apo kërkesave kualifikuese të kenë parasysh që mund të kërkohen vetëm ato Certifikata që janë ngushtë të lidhura me sigurimin e cilësisë dhe kualitetit të lëndës së prokurimit. Departamenti i Monitorimit do të përcjellë këtë dukuri dhe në rast se konstaton se AK nuk marrin parasysh këto rekomandime dhe vazhdojnë të përdorin kërkesa kufizuese, KRPP do të ndërmarrë masat e përcaktuara me nenet 98 dhe 99 të Rregullores nr. 82/2022 për Prokurimin Publik). Përveç kërkeses per Certifikaten ISO 9001, Autoriteti Kontraktues nuk ka sqaruar ne detaje lidhur me Autorizimin e produkteve. Ne kemi kerkuar te sakteson per cilat produkte eshte kerkuar Autorizim. Ne baze te pergjigjes mund te kuptohet qe Autorizimi eshte kerkuar edhe per HDD Kerkesa ne dosje te tenderit: Nuk eshte praktike te kerkohet Autorizim per HDD, kufje dhe te ngjajshme. Mos saktesimi konkretisht per secilin produkte veç e veç, te ben te kuptosh qe kerkohet Autorizim edhe per HDD. Per shkak te vendosjes se disa produkteve nje pozicion, ne kemi kerkuar nga Autoriteti juaj qe te ndaj produktet me tosh te ndryshme, sepse kerkesa per faturim te disa produkteve ne nje rresht me tosh te ndryshme eshte ne funksion te shkeljes se ligjit te tosh-se. Prandaj kerkojme nga Autoriteti juaj qe te shqyrtoj kerkesen tone, te largon kerkesat administrative te cilat favorizojne ndonje operator ekonomik apo demtojne konkurrencen per kete aktivitet prokurimi, kerkesat (ISO) nuk kane asnje ndikim pozitiv te AK, sepse kemi te bejme me furnizim”.*

Fillimisht duhet sqaruar se pretendimet ankimore i referohen kërkesës për kapacitetin teknik dhe profesional të formuluar në dosjen e tenderit si në vijim:

OE duhet te jete I certifikuar me ISO 9001 dhe 27001 origjinal ose kopje e noterizuar nga origjinali	Certifikata ISO 9001 dhe 27001 origjinal ose kopje e noterizuar nga origjinali
---	---

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se argumenti qëndror i parashtruesit i referohet interpretimit të KRPP me nr. 26 të datës 09.06.2023 i cili është cituar si më sipër në kuadër të pretendimeve ankimore. Si i tillë ky argument është i qëndrueshëm pasi që interpretimet nga KRPP janë të obligueshme për të gjitha autoritetet kontraktuese në të gjitha aktivitetet e prokurimit pa përjashtim. Rrjedhimisht edhe argumentet shtesë të parashtruesit sipas të cilave kërkesat për ISO nuk janë të ndërlidhura mjaftueshëm me qëllimin e aktivitetit e prokurimit janë argumente të pranueshme. Së këndejmi vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se *“Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik”.*

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 25.10.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.